


Katalogu i publikimeve

Banka e Shqipërisë



1999-2004



PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| HYRJE | 5 |
| PUBLIKIMET PERIODIKE | |
| RAPORTI VJETOR | 7 |
| RAPORTET E POLITIKËS MONETARE | 8 |
| RAPORTI MUJOR STATISTIKOR | 9 |
| BULETINI ZYRTAR | 9 |
| BULETINI EKONOMIK | 10 |
| RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES BANKARE | 10 |
| RAPORTI VJETOR I BILANCIT TË PAGESAVE | 11 |
| EKONOMIA SHQIPTARE, SHIFRA DHE FAKTE | 12 |
| PUBLIKIME JOPERIODIKE | |
| MATERIALE DISKUTIMI | 13 |
| KONFERENCA TË ORGANIZUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË | 20 |
| KOLANA JURIDIKE: | 23 |
| KOLANA EDUKATIVE: | 23 |
| TË TJERA | 27 |



HJRJE

Katalogu i Publikimeve të Bankës së Shqipërisë është një përmbledhje e kolanave periodike, e raporteve periodike ose jo; dhe e të tjera botimeve që përgatishim për bankat tregtare, për institucione të ndryshme e individë, për publikun e gjerë në përgjithësi, brenda e jashtë vendit.

Shpërndarja e tyre bëhet falas, sipas një liste e cila përfshin administratën publike, bankat e nivelit të dytë, institucione të ndryshme dhe këdo tjetër që është i interesuar për to.

Si një përpjekje e parë e jona, për të vënë në dispozicion të lexuesit, një informacion më shumë, që ju ndihmon të jeni më afër nesh, shpresoj ta gjeni të dobishëm. Katalogu i publikimeve do të përgatitet e shpërndahet në mënyrë të përvitshme, dhe më pas këtij numri, do të përmbajë vetëm titujt e publikuar në vitin respektiv.

Në këtë numër të parë, me dëshirën e mirë për të ekspozuar sa më shumë nga botimet tona që mund t'iu shërbejnë në punën, në aktivitetin apo edhe në jetën tuaj të përditshme, kemi bërë një renditje të numrit më të konsiderueshëm të tyre.

Sinqerisht, dua të besoj që do të na mirëprisni,

Ina Kraja

Drejtoreshë e Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun.



RAPORTI VJETOR

Raporti Vjetor prezanton komentet e Guvernatorit rreth situatës ekonomike dhe monetare dhe gjithashtu, përshkruan aktivitetet e Bankës së Shqipërisë. Botohet një herë në vit dhe përmban informacion mbi zhvillimin ekonomik në vend, politikën monetare, tregun valutor, mbikëqyrjen bankare, operacionet monetare të Bankës së Shqipërisë, zhvillimin e sistemit të pagesave etj..

Raporti Vjetor, i cili i dorëzohet Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe Parlamentit nga Guvernatori në emër të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, konsiston në:

- fjalën e Guvernatorit rreth situatës ekonomike dhe monetare në Shqipëri;
- përshkrimin me hollësi të zhvillimeve në sektorët e ekonomisë gjatë një viti, duke u ndalur tek politika monetare e ndjekur dhe tek aktivitete të tjera të Bankës së Shqipërisë;
- përshkrimin me hollësi të zhvillimeve në sektorin bankar përfshirë edhe përmirësimet e bazës rregullatore;
- pasqyrimin me vërtetësi të bilancit kontabël, të deklaratës financiare si dhe të pasqyrave shpjeguese përfshirë dhe deklaratën e auditorit;
- përshkrimin e aktiviteteve të tjera të Bankës së Shqipërisë;
- shpjegimin e punës dhe arritjeve të Bankës së Shqipërisë gjatë një viti kalendarik dhe gjithashtu, ekspozon sfidat dhe qëllimet për vitin e ardhshëm.



RAPORTET E POLITIKËS MONETARE

Vendimmarrja politike e Bankës së Shqipërisë është një e drejtë ekskluzive e Këshillit Mbikëqyrës së saj. Ky proces vendimmarrjeje bazohet në analizat dhe në parashikimet që çdo muaj të vitit janë pjesë e njërit prej raporteve të mëposhtme të politikës monetare:

1. *Raporti Mujor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare për dy muajt e ndërmjetëm të çdo tremujori. Një vend të rëndësishëm përbën qëndrimi që duhet mbajtur në të ardhmen.*
2. *Raporti Tremujor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare për tremujorin e parë dhe për nëntëmujorin. Një vend të rëndësishëm përbën qëndrimi që duhet mbajtur në të ardhmen.*
3. *Raporti Gjashtëmujor i Politikës Monetare. Ky raport analizon dhe vlerëson zhvillimet ekonomike e financiare të ekonomisë shqiptare gjatë gjashtë muajve të parë ose të fundit të një viti të caktuar. Në varësi të këtyre zhvillimeve, të ndikimit të tyre në inflacionin e periudhës së shqyrtuar dhe të pritjeve për të ardhmen jepet dhe qëndrimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.*

| Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|--------------|--------------|---------------------------------------|--------------|--------------|---|
| Raport Mujor | Raport Mujor | Raporti Tremujor i Politikës Monetare | Raport Mujor | Raport Mujor | Raporti Gjashtëmujor i Politikës Monetare |
| Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| Raport Mujor | Raport Mujor | Raporti Tremujor i Politikës Monetare | Raport Mujor | Raport Mujor | Raporti Gjashtëmujor i Politikës Monetare |



Dokumenti i politikës monetare. Një përmbledhje e thjeshtuar e politikës monetare, që Banka e Shqipërisë do të ndjekë gjatë një viti kalendarik.

RAPORTI MUJOR STATISTIKOR

Raporti statistikor paraqet të dhëna me periodicitet të ndryshëm në lidhje me kategoritë e mëposhtme statistikore:

1. Statistikat e Bilancit të Pagesave;
2. Statistikat monetare financiare;
3. Llogaritë e sektorit bankar.

Përveç këtyre në raport jepen edhe informacione statistikore në lidhje me:

- disa tregues makroekonomikë si PBB, inflacioni, papunësia, kursi i këmbimit;
- gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë;
- pasqyrat e mbikëqyrjes bankare etj..

BULETINI ZYRTAR

Në kuadër të transparencës Banka e Shqipërisë publikon disa prej vendimeve të marra nga Këshilli i saj Mbikëqyrës. Ky buletin përgatitet në varësi të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës.



BULETINI EKONOMIK

Buletini Ekonomik përmbledh analiza, vlerësime që kanë të bëjnë me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë si dhe informacione të ndryshme mbi sistemin bankar. Ky publikim ka një frekuencë tremujore dhe përmban: deklaratat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, të cilat përpilohen në zbatim të kërkesave të ligjit në fuqi “Për Bankën e Shqipërisë” si deklarata për politikën monetare, opinioni i pavarur mbi gjendjen e ekonomisë shqiptare, deklarata të bilancit të pagesave; prezencën e administratorëve të Bankës së Shqipërisë në publik; artikuj të ndryshëm që trajtojnë çështje ekonomike, financiare e juridike; rezultate të vrojtimeve statistikore të kryera nga Banka e Shqipërisë; të dhëna statistikore mbi sistemin bankar; situatën monetare dhe ekonominë reale; listën e bankave të nivelit të dytë që kanë marrë licencë për të operuar në Republikën e Shqipërisë, adresat dhe kontaktet e tyre, listën e zyrave të këmbimit valutor që kanë marrë licencë nga Banka e Shqipërisë dhe adresat e tyre; strukturën organizative dhe drejtuesit e Bankës së Shqipërisë (anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe drejtorët e departamenteve).

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES BANKARE

Paraqet një analizë vjetore të veprimtarisë së sistemit bankar dhe të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë.

Analiza ndalet në detaje, në tregues si struktura e aktiveve, aktiviteti kreditues e depozitues, si dhe çështje të performancës së sistemit bankar.

Ky raport paraqet zhvillimet më të rëndësishme të vitit në sistemin bankar dhe projekte të reja në fushën e mbikëqyrjes bankare. Në raport gjenden statistika dhe informacione mbi subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë.

RAPORTI VJETOR I BILANCIT TË PAGESAVE

Raporti Vjetor i Bilancit të Pagesave analizon hollësisht zhvillimet e sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare, për vitin përkatës. Në këtë botim, bëhet një analizë e bilancit të pagesave sipas zërave të veçantë të llogarisë korente dhe llogarisë kapitale dhe financiare. Botimi përmban analiza të detajuara të zhvillimeve në tregtinë e jashtme sipas grupmallrave dhe shteteve, analiza të ecurisë së shërbimeve, të të ardhurave, të transfertave korente dhe transaksioneve në llogarinë kapitale dhe financiare.

Nëpërmjet një përshkrimi sintetik, ofron për përdoruesit e pasqyrës së bilancit të pagesave njohje me konceptin “bilanc pagesash”, duke prezantuar njëkohësisht burimet dhe metodologjinë e përdorur në hartimin e Bilancit Shqiptar të Pagesave.

Buletini përmban, gjithashtu, një aneks statistikor ku do të gjeni seri kohore të dhënash për zërat kryesorë të bilancit të pagesave.



EKONOMIA SHQIPTARE, SHIFRA DHE FAKTE

Është një fletëpalosje e cila botohet një herë në vit dhe pasqyron situatën ekonomike dhe financiare të Shqipërisë në shifra dhe fakte. Është një publikim i dobishëm dhe praktik.

MATERIALE DISKUTIMI

Këto janë studime, analiza kërkimore mbi çështje të ndryshme të sistemit bankar. Ato prekin aspekte teorike dhe praktike me rëndësi për zhvillimet ekonomike, për jetën aktuale financiare të vendit dhe pritjeve për zhvillim. Në këto materiale gjenden analiza krahasuese, konstatime, propozime dhe ide të reja. Ato përgatiten nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë. Shpesh herë pikëpamjet e shprehura në këto materiale janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

PAVARËSIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

SHKËLQIM CANI, TEUTA BALETA NR. 1/99; SHTATOR 1999
Bankën qendrore duhet ta përfytyrojmë si një institucion që vepron në një mjedis me rregulla të përcaktuar ose brenda disa kornizave të caktuara. Këto korniza caktohen nga Kuvendi, organi më i lartë legjislativ i vendit. Banka qendrore varet prej këtij organi dhe raporton tek ai. Kornizat që caktohen nga Kuvendi nuk janë gjë tjetër veçse caktimi ose renditja e objektivave apo detyrave që duhet të kryejë një bankë qendrore.

BAZAT TEORIKE TË PROGRAMIMIT MONETAR. RASTI I SHQIPËRISË

PROF.DR. MARTA MUÇO, AMIKA STAVRI, MBA NR.1 (2/00); QERSHOR 2000

Nevoja për të pasur një program financiar është tashmë e pranuar për ekonominë e të gjitha vendeve. Ai bëhet edhe më i nevojshëm për vendet të cilat shfaqin situata të



*theksuara disekuilibri makroekonomik dhe deformime e
hezitime në politikat ekonomike që duhet të ndiqen.*

ANALIZË KRAHASUESE E SISTEMEVE TË TAKSAVE NË DISA VENDE TË RAJONIT

DR.SELAMI XHEPA NR. 2 (3/00); SHTATOR 2000

*Ideja e përgatitjes së një materiali të tillë erdhi që në
periudhën e ndryshimit të sistemit tatimor, në fillim të vitit
1998, kur argumenti që u përdor për të justifikuar këtë
masë ishte se vendi ynë ka nivelin më të ulët të taksave
në rajon dhe se ka përsëri hapësira për rritjen e tyre; se
tërheqja e kapitalit të huaj bazohet në sistemin e një regjimi
liberal, që vendi ynë tashmë kishte adoptuar.*

*Në fakt, siç përpiqet të evidentojë materiali në vijim, asnjëri
prej këtyre argumenteve nuk qëndron mbi një terren të
argumentuar.*

DOMINIMI I SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR

TEUTA BALETA, NERITAN KALLFA, LULJETA FILE, FIQIRI
BAHOLLI, SUELA BOKSHI, EDLIRA ABAZI NR. 3 (4/00),
SHTATOR 2000

*Sistemi bankar shqiptar është i monopolizuar. Në të nuk
ka konkurrencë. Këto fjali përmenden shpesh në diskutimet
midis specialistëve të Bankës së Shqipërisë lidhur me
zbatimin efikas të instrumenteve të politikës monetare, me
zbatimin me rigorozitet të rregullave të mbikëqyrjes, me
nxitjen e zhvillimit të sistemit të pagesave, me prezantimin e
instrumenteve të reja të politikës monetare apo me nxitjen
e zhvillimit të tregut të letrave me vlerë.*

ASPEKTE TË PERFORMANCAVE TË EKSPORTEVE SHQIPTARE

DR. SELAMI XHEPA, ARGITA FRASHËRI NR. 1 (5/01); JANAR 2001

Duke konsideruar që aktiviteti i tregtisë së jashtme zë një vend të rëndësishëm në jetën ekonomike të vendit, dinamikat dhe zhvillimet e tij mund të jenë domethënëse nga pikëpamja e luhatjeve të ciklit të biznesit. Në këtë kuptim, tregtia e jashtme mund të përdoret si një instrument në kundërbalancimin e luhatjeve ciklike në të cilat kalon ekonomia.

A paraqet tregtia e jashtme shqiptare efekte gjeneruese për ekonominë e vendit dhe cili komponent i tij duket më i rëndësishëm?

BANKAT E HUAJA NË RAJONIN E BALLKANIT

TEUTA BALETA, DR. SELAMI XHEPA NR. 2 (6/01); SHKURT 2001

Një dekadë më parë, 15 vendeve të Evropës Lindore e Qendrore iu desh të fillonin nga e para procesin e krijimit ose të rikrijimit, të një sistemi financiar plotësisht funksional aty ku nuk kishte ekzistuar më parë ose në rastin më të mirë, nuk kishte ekzistuar për të paktën 40 vitet e fundit.

Ballafaqimi me shumë probleme në sistemet bankare ekzistuese bëri që këto vende të hynin në rrugën e reformimit të tyre.



EUROIZIMI I EKONOMISË SHQIPTARE, NJË ALTERNATIVË PËR T'U KONSIDERUAR

DR.SELAMI XHEPA NR. 1 (7/02); SHKURT 2002

Përdorimi i monedhave të huaja, veçanërisht dollarit amerikan dhe monedhave europiane përbërëse të euros është bërë një realitet në ambientin shqiptar, ashtu sikurse vepron në gati gjithë ekonominë e hapura të vendeve në zhvillim.

Praktika e përdorimit të monedhave të huaja në Shqipëri shtrihet që nga politikat e çmimit të firmave prodhuese e tregtare, tek familjet shqiptare që mbajnë kursimet e tyre në monedha të huaja, tek aktiviteti i bankave dhe marrëdhëniet e tyre me biznesin (në kreditim) etj..

PËRMIRËSIMI I KUADRIT OPERACIONAL TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE NXITJA E TREGUT NDËRBANKAR

ARTA PISHA, SUZANA SHEQERI NR. 2 (8/02); MAJ 2002

Përcaktimi i drejtimeve të përmirësimit të kuadrit operacional është parë dhe në funksion të nxitjes së tregut ndërbankar.

Përmirësimet e mundshme që mund t'i bëhen kuadrit operacional të Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe drejtimet afatmesme dhe afatgjata të nxitjes së tregut ndërbankar, do t'i shërbejnë Bankës së Shqipërisë për të rritur eficiencën e zbatimit të politikës së saj monetare.

BORXHI I JASHTËM I SHQIPËRISË DHE SHËRBIMI I TIJ

SONILA TAÇI NR. 3 (9/02); SHTATOR 2002

Borxhi i jashtëm konsiderohet si një element i rëndësishëm i menaxhimit makroekonomik. Ai përfaqëson një levë, që po u përdor mirë e me efektivitet, i jep shtysë pozitive rritjes ekonomike, e nëse përdoret keq, mund të shkohet deri aty, sa ta sjellë vendin në kufijtë e krizës financiare.

SHKALLA E NDËRMJETËSIMIT FINANCIAR NË SHQIPËRI

ERJONA SULJOTI NR. 4 (10/02); SHTATOR 2002

Në ditët e sotme institucionet financiare banka, luajnë një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e fondeve, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në nxitjen e investimeve dhe në rritjen ekonomike. Ky fakt merr një rëndësi më të madhe për vendet në zhvillim me një sektor financiar të brishtë, si në rastin e Shqipërisë. Materiali në vazhdim përbën një analizë në këndvështrimin tradicional të treguesve të ndërmjetësimit të Shqipërisë, për periudhën e tranzicionit deri në vitin 2001. Ecuria e treguesve të ndërmjetësimit të sistemit bankar shqiptar është krahasuar dhe me ecurinë e këtyre treguesve për sistemet bankare të disa prej vendeve të rajonit.

KRAHASIMI I NORMAVE TË INTERESIT NË RAJON

ARTA PISHA NR. 5 (11/02); TETOR 2002

Në vendet e Evropës Juglindore, ndonëse struktura financiare dhe kushtet makroekonomike janë të ndryshme, vërehen dhe pika afrimi, të cilat po zgjerohen gjithnjë e më



tepër. Kjo kryesisht në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ku këto vende po përpiqen gjithnjë e më tepër të plotësojnë kriteret e nevojshme për integrim në rajon dhe në Evropën e Bashkuar, që do të thotë ngushtim i dallimeve midis tyre.

KONTRIBUTI I INFLACIONEVE TË MALLRAVE TË TREGTUESHËM DHE TË PATREGTUESHËM NË INFLACIONIN TOTAL: RASTI I SHQIPËRISË

EVELINA ÇELIKU NR. 1 (12/03); JANAR 2003

Studimi ka për qëllim, të analizojë inflacionin në Shqipëri, si rrjedhojë e ndryshimeve të çmimeve në sektorët e tregtueshëm dhe të patregtueshëm të mallrave dhe shërbimeve të shportës mbi të cilën bazohet aktualisht matja e këtij treguesi. Në këtë aspekt, janë bërë përpjekje për shpjegimin dhe matjen e efektit të Balassa- Samuelson, në rastin e Shqipërisë, duke evidentuar ndikimet e ndryshimit të çmimeve të sektorit të patregtueshëm mbi atë të tregtueshmin. Ky aspekt merr një rëndësi të veçantë, për të vlerësuar këto ndikime, në pritje të rritjes së çmimeve të ujit, të energjisë elektrike etj.. Në studim është analizuar sjellja e inflacionit sipas sektorëve dhe brenda tyre, si edhe janë vlerësuar faktorët sezonalë, sidomos ata të fundvitit për sektorët dhe për nëngrupet e veçanta të tyre.

TRONDITJET E SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR DHE POLITIKAT E BANKËS SË SHQIPËRISË

SUZANA SHEQERI NR. 2 (13/03), SHKURT 2003

Ky material ka si qëllim trajtimin e periudhave të tronditjeve të sistemit bankar në Shqipëri, evidentimin e të përbashkëtave dhe dallimeve për këto periudha,

shkaqet që çuan në ndodhjen e tyre, ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë dhe shpejtësinë e recuperimit të krizave të likuiditetit. Nëpërmjet analizës së ambientit të përgjithshëm makroekonomik dhe mikroekonomik janë identifikuar rrënjët e këtyre tronditjeve dhe kushtet në të cilat rritet mundësia e ndodhjes së tronditjeve, si dhe është përcaktuar një formë sjelljeje e Bankës së Shqipërisë në raste të ngjashme në të ardhmen.

A ËSHTË RASTI PËR NJË RITJE TË MËTEJSHME TË KAPITALIT MINIMAL NË SHQIPËRI

ERJON LUÇI NR. 3 (14/03); SHTATOR 2003

Në këtë material jemi përpjekur të sjellim disa argumente pro dhe kundër rritjes së mëtejshme të nivelit aktual të kapitalit minimal të bankave tregtare në Shqipëri. Për momentin, duhet thënë se argumentet në mbështetje të rritjes së kapitalit nuk janë shumë bindëse, veçanërisht në kushtet kur ekzistojnë mënyra të tjera më eficiente për ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar.

FORMULIMI I NJË TEORIE PËR NDËRMJETËSIMIN FINANCIAR NË TRANZICION

ERJON LUÇI NR. 1 (15/04); MARS 2004

Në këtë punim propozohet një teori alternative ndaj asaj tradicionale për ndërmjetësimin financiar bazuar në literaturën e racionimit të kredisë, e cila gjykohet më e përshtatshme në rastin e vendeve në tranzicion. Një prej implikimeve kryesore të kësaj teorie është se koordinimi i reformave të ndryshme, sidomos i atyre institucionale, është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e shpejtë të ndërmjetësimit financiar në vendet në tranzicion.



NDIKIMI I QËNDRUESHMËRISË SË SITUATËS MAKROEKONOMIKE NË NIVELIN E KREDIVE ME PROBLEME

ERJON LUÇI, EVELINA ÇELIKU NR. 2 (16/04); MARS 2004
Në këtë punim jemi përpjekur të analizojmë lidhjen që ekziston midis situatës makroekonomike dhe disa faktorëve të tjerë dhe kredive me probleme në vendet e tranzicionit dhe në rastin e Shqipërisë. Nga kjo analizë del se efekti i situatës makroekonomike luan një rol të rëndësishëm në Shqipëri për nivelin e kredive me probleme. Ndërkohë që eksperiencia e vendeve në tranzicion sugjeron se përmirësimi i ligjit është një faktor tjetër i rëndësishëm në reduktimin e kredive me probleme.

KONFERENCA TË ORGANIZUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë duke filluar që nga nëntori i vitit 2000 organizon çdo vit konferenca ndërkombëtare shkencore, forume ku ekspertë, akademikë, vendimmarrës etj., vendas dhe të huaj, këmbëjnë pikëpamjet, hedhin ide, sjellin eksperiencia të ndryshme.

KONFERENCA I, TIRANË 2 - 3 NËNTOR 2000
"INFORMACIONI STATISTIKOR NË SHQIPËRI".
Në datat 2 - 3 nëntor 2000, Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave INSTAT, organizuan në Tiranë konferencën kombëtare mbi "Informacionin statistikor në Shqipëri". Me pjesëmarrjen e një auditori të gjerë, prodhues dhe përdorues të statistikave, përfaqësues të institucioneve shtetërore, komunitetit të biznesit privat,



organizatave joqeveritare, institucioneve kërkimore dhe shkencore të vendit, por edhe të të ftuarve nga institucionet ndërkombëtare si FMN, Komisioni Evropian, Bordi i Guvernatorëve të Rezervës Federale, Eurostat-it etj., konferenca synoi në vlerësimin e gjendjes aktuale të zhvillimit të statistikave; në rolin dhe rëndësinë që ka informacioni statistikor në marrjen e vendimeve për politikat ekonomike; në sensibilizimin e autoriteteve ekzekutive, të komunitetit të biznesit privat dhe publikut në tërësi etj..

KONFERENCA II, TIRANË 6 - 7 DHJETOR 2001 "SHQIPËRIA MIDIS REFORMAVE TË BRENDSHME DHE INTEGRIMIT EVROPIAN".

Konferenca "Shqipëria midis reformave të brendshme dhe integritimit evropian" e organizuar bashkërisht nga Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë, mori shkas nga 10-vjetori i anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në institucionet financiare ndërkombëtare: Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. Më shumë se 10 vjet më pas nga koha kur Shqipëria përmbysi regjimin totalitar dhe u orientua drejt ekonomisë së tregut e po ecën me hapa të shpejtë në rrugën e reformave demokratike dhe ekonomike, u pa me vend që ekspertët dhe vendimmarrësit të mbledheshin për të analizuar arritjet, dështimet si dhe sfidat e së ardhmes.

KONFERENCA III, TIRANË 5 - 6 DHJETOR 2002 "BANKA E SHQIPËRISË NË DEKADËN E DYTË TË TRANZICIONIT".

Përvjetorit të dhjetë të ekzistencës së saj moderniste Banka e Shqipërisë i kushtoi konferencën e tretë të saj, e cila ashtu si dy të parat u mbajt në muajin dhjetor në Pallatin e Kongreseve në qytetin e Tiranës. Banka e Shqipërisë e krijuar sipas konceptit modern të bankës qendrore 10 vjet

publikimet joperiodike

më parë, ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e reformës ekonomike dhe në tërësi në ekonominë e vendit gjatë dekadës së parë të tranzicionit. Ky rol ka ardhur duke u forcuar me forcimin e pavarësisë ligjore dhe reale të saj si dhe me shtimin e përvojës dhe të njohurive në fushën ekonomike e financiare.

Problemet e tranzicionit shqiptar kanë krijuar madje përvoja unike një pjesë e të cilave janë trajtuar me mjaft kujdes dhe janë kapërcyer mirë prej Bankës së Shqipërisë. Është e qartë që rruga për në Bashkimin Evropian kërkon kohë.

Megjithatë, është e dobishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për suksesin e reformës institucionale që të gjithë të punojmë duke e patur të qartë objektivin tonë afatgjatë. Kjo do të lehtësojë konturimin e të ardhmes dhe, nëse ekziston vullneti i mirë, do të përshpejtojë zhvillimin.

KONFERENCA IV, SARANDË 11 - 12 SHTATOR 2003
"EKONOMIA SHQIPTARE: ECURIA DHE SFIDAT E POLITIKAVE EKONOMIKE".

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, organizoi në qytetin e Sarandës konferencën me temë "Ekonomia shqiptare: ecuria dhe sfidat e politikave ekonomike".

Fokusi i saj kryesisht u ndal në zhvillimet e ekonomisë së tregut në Shqipëri, në disa çështje që kanë të bëjnë me sektorin e jashtëm të vendit si dhe në disa aspekte të veçanta të bankingsut qendror të rajonit. Në konferencë ishin të ftuar, përfaqësues të sistemit bankar, të rretheve akademike, të institucioneve të ndryshme financiare të huaj dhe vendas.



KOLANA JURIDIKE:

Kolana e publikimeve juridike përbëhet nga botime të ligjeve dhe të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, të sistemit bankar e më gjerë. Ato janë të dobishme për Bankën e Shqipërisë; për administratën publike, për bankat e nivelit të dytë; për zyrat e këmbimit valutor; për institucione të ndryshme financiare e individë të lidhur me sistemin bankar ose jo.

1. Ligji “Për Bankën e Shqipërisë”;
2. Ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
3. Komentari i ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”;
4. Komentari i ligjit për “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
5. Libri i ligjeve dhe i rregulloreve të Bankës së Shqipërisë vëllimi 1, vëllimi 2.

KOLANA EDUKATIVE:

Këto publikime konsistojnë në broshura, fletëpalosje, fletëvolante të cilat janë përgatitur me qëllimin për t'i transmetuar publikut të thjeshtë një mesazh, koncept apo ide në mënyrë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme.

BROSHURA:

- [Banka Qendrore Evropiane](#). Është një broshurë që i sjell publikut mjaft informacion për organizimin dhe mënyrën e funksionimit të institucionit të Bankës Qendrore Evropiane, për drejtimin dhe drejtuesit e saj, si dhe për bankat qendrore

publikimet joperiodike

të vendeve anëtare. Me një gjuhë të thjeshtë, broshura shpjegon hallkat nëpër të cilat kalon formulimi dhe zbatimi i politikës monetare të njehsuar në territorin e Bashkimit Evropian, duke bërë dallimin midis vendeve anëtare në Eurozonë dhe atyre jashtë saj. Kjo broshurë, ofron edhe adresat e kontaktit për të gjitha bankat qendrore anëtare të BE-së. Botimi është vetëm në gjuhën shqipe.

- **Historia e Akullores. Inflacioni: ç'duhet të dimë për të. Të flasim thjesht për inflacionin.** Janë 3 broshura të cilat synojnë të shpjegojnë me një gjuhë të thjeshtë se ç'është inflacioni dhe pse flitet kaq shumë për të. Të konceptuara si një seri broshurash të karakterit edukativ, ato i drejtohen shtresave të ndryshme të publikut, që fillojnë me nxënësit e shkollave 8 - vjeçare (Historia e Akullores) vazhdojnë me ata më të rriturit (Të flasim thjesht për inflacionin) për të dhënë një shpjegim më profesional tek broshura e fundit. Në funksion të kësaj ideje, dy broshurat e para janë edhe të ilustruara.
- **Sistemi i pagesave** për herë të parë synon të prezantojë thjesht para publikut shqiptar cilat janë mjetet e pagesave, ç'është një sistem pagesash, cilët janë përbërësit e tij. Gjithashtu, kjo broshurë jep edhe një pamje të sistemit tonë të pagesave dhe të rolit të Bankës së Shqipërisë në këtë sistem. Botimi është përgatitur vetëm në gjuhën shqipe.
- **Instrumentet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë dhe procedurat për realizimin e tyre.** Një broshurë që shpjegon kuadrin operacional të Bankës së Shqipërisë dhe mënyrën e funksionimit të tij. Duke qenë vijim edhe i një tjetër publikimi për këtë qëllim, ajo është përpjekur të shpjegojë



publikimet joperiodike

më gjerësisht dhe me një gjuhë sa më të kuptuar nga publiku se si funksionon dhe si është i rregulluar ky kuadër. Broshura është botuar edhe në gjuhën angleze.

- **Pak fjalë për Bankën Qendrore.** Një broshurë e ilustruar me informacion të përgjithshëm për Bankën Qendrore dhe aktivitetin e saj.
- **Bonot e thesarit. Si t'i njohim ne ato? Si fitohet prej tyre?** Është një nga publikimet më të dobishme të këtij lloji. E shkruar në shqip dhe anglisht, publiku e gjeti shumë të përshtatshme për të plotësuar njohuritë e tij rreth bonove të thesarit, mënyrës së investimit në to dhe përparësive të tjera që ofrojnë.
- **Komuniteti Evropian dhe Euro.** Është vetëm një pjesë e publikimeve, shkrimeve të publikuara në revista ekonomike, seminareve të mbajtura në ambiente të ndryshme brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë në fushatën njohëse të euros nga publiku shqiptar, në të cilën Banka e Shqipërisë u angazhua gjatë gjithë vitit 2000. Informacioni që i jepet publikut nëpërmjet saj është i thjeshtë, i kuptueshëm dhe i qartë në synimin njohës që ka. Broshura është e disponueshme në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.
- **Broshura e Bilancit të Pagesave.** Është një broshurë e shkruar thjesht dhe me një gjuhë të kuptueshme për publikun, që sqaron ç'është bilanci i pagesave, sa familjarë ne të gjithë jemi me të në jetën e përditshme dhe sa të rëndësishme janë statistikat e bilancit të pagesave për ekonominë e një vendi. Është shkruar vetëm në shqip.
- **Sistemi bankar në Shqipëri.** Është një botim tjetër në serinë e broshurave që janë publikuar për



publikimet joperiodike

qëllime të njohjes së publikut me institucionin e bankës, me mënyrën e funksionimit të saj, me përparësitë e të punuarit me to dhe sigurinë që ato ofrojnë. Broshura është shkruar në shqip dhe anglisht.

- **Euro, paraja jonë.** Elementet e sigurisë së kartëmonedhave euro. Është një tjetër broshurë, mjaft mirë e ilustruar dhe që ndihmon secilin që e merr në dorë, për t'u njohur deri në detaje me monedhën e re. Sidomos, i vë theksin elementeve të sigurisë së monedhës së re. Është e shkruar vetëm në gjuhën shqipe.
- **Departamentet e Bankës së Shqipërisë.** Është një publikim për funksionet dhe detajet e departamenteve të Bankës së Shqipërisë.

FLETËPALOSJE:

- **Përgatitjet për euron.** Udhëzuesi juaj për kartëmonedhat dhe monedhat Euro. Një broshurë që jep informacion për monedhën e re dhe shenjat e saj të sigurisë. E plotë jo vetëm në të dhënat që përmban, por edhe në ilustrimet e secilës prej kartëmonedhave.
- **Mbikëqyrja Bankare.** Një përmbledhje shifrash dhe të dhënash për sistemin bankar shqiptar.
- **Teknologjia e Informacionit.** Një paraqitje e përmbledhur e ilustruar me skemë, për aktivitetin e teknologjisë së informacionit dhe shërbimet që ajo ofron në Bankën e Shqipërisë.
- **Burimet Njerëzore.** Struktura organizative e momentit në Bankën e Shqipërisë dhe si ka ndryshuar ajo nëpër vite.
- **Investimi në bonot e thesarit.** Një fletëpalosje me



publikimet joperiodike

karakter shpjegues që synon të sqarojë publikun për mënyrën e investimit në bonot e thesarit dhe përparësitë e këtij investimi.

- **Sistemi i Pagesave.** Në shqip dhe anglisht, është veçuar nga broshura me të njëjtin titull, duke synuar të nënvizojë në publik se çfarë përfaqëson sistemi i pagesave në vendin tonë, shkallën e zhvillimit të tij dhe cili është roli i Bankës sonë Qendrore në këtë sistem.

FLETËVOLANT:

- **Sistemi i sigurimit të depozitave në Shqipëri.** Një përshkrim i shkurtër dhe i thjeshtë mbi funksionet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD). Përfitimet e depozituesve nga aktiviteti i saj.
- **Një vështrim i përgjithshëm mbi monedhat euro.** Siç edhe dihet Banka e Shqipërisë, zhvilloi një fushatë për njohjen e euros dhe publikimi e shpërndarja e këtij fletëvolanti ishte pjesë e kësaj fushate. Në gjuhën gjermane ai kishte pamje mjaft të qarta të monedhave të reja, ndërsa në fletën në shqip që e shoqëronte ishin të përkthyer të gjitha të dhënat për secilën prerje.

TË TJERA:

1. Manuali i Kontabilitetit Bankar.
2. Manuali i Kontabilitetit Bankar. Shembuj.
3. Plani i zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë 2003 – 2005.
4. Analiza vrojtimi.
5. Manuali i Inspektimit.
6. Historiku i Bankës së Shqipërisë.



publikimet joperiodike

*Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike
në adresën:*

www.bankofalbania.org

*Gjithashtu në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri, Tel.: +355-
(0)4-222152; Fax: +355-(0)4-223558*

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 1000 kopje

